



Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit
Janar 2020

Qeverisja e hapur është qeverisje e përgjegjshme!

Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve në financat publike vendore është një hap i rëndësishëm në vlerësimin e kapacitetit financiar të tyre në funksion të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Një kuptim më i mirë i raportit kompetenca – burime financiare të disponueshme informon hartimin e politikave **efektive** dhe **eficiente** në qeverisjen vendore, lehtëson **dialogun** ndërmjet niveleve të qeverisjes, informon mbi **kapacitetin** huamarrës, përmirëson **llogaridhënien**, **transparencën** dhe **besimin** e komunitetit në **përfaqësuesit vendorë**.

Raporti i Financave Publike Vendore paraqet një analizë të detajuar të ecurisë së burimeve financiare vendore sipas kategorive dhe shpenzimet e kryera nga qeverisja vendore me fonde të veta dhe me fonde të kushtëzuara, ndërthurur me natyrën ekonomike dhe funksionale të tyre. Kjo analizë përmbledh zhvillimet përgjatë **nëntëmujorit të parë të vitit 2019 (9M2019)**.

Qeverisja e hapur është qeverisje e përgjegjshme!

Analiza e burimeve të financimit për 61 bashkitë gjatë 9M2019:

- Të ardhura nga burime të veta vendore;
- Transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale;
- Taksa të ndara;
- Transferta të kushtëzuara për funksione të deleguara.


Burime
financiare **të
disponueshme**

Burime
financiare
totale

► **Të ardhura nga burime të veta vendore:**


- Të ardhurat nga taskat;
- Të ardhura nga tarifat vendore;
- Të ardhura të tjera nga burime vendore.

Të ardhurat nga **burime të veta vendore** regjistruan një nivel prej rreth 20.7 miliard lekë, në rritje me rreth 20.5% në terma vjetorë.




Burimi: www.financatvendore.al

Nëse nga totali i të ardhurave nga burimet e veta vendore do të zbrisnim ato të përfuara nga bashkia Tiranë, si një entitet me përmasa dhe në kushte krejtësisht të ndryshme nga 60 bashkitë e tjera në vend, atëherë norma e rritjes së të ardhurave vendore për periudhën e konsideruar do të moderohet në rreth 8.5% në terma vjetorë.




Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfaqësojnë rreth 33.5% ndaj burimeve financiare totale. Në terma vjetorë, ky raport u përmirësua me rreth 4.1 pikë përqindjeje dhe qëndron rreth 6.3 pikë përqindjeje mbi mesataren afatgjatë. Përjashtuar bashkinë Tiranë, ky raport u vlerësua në rreth 15%, në përmirësim nga një vit më parë dhe ndodhet lehtësisht nën mesataren afatgjatë.




Burimi: www.financatvendore.al

Zhvillimet pozitive në ecurinë e të ardhurave nga burimet e veta vendore vijojnë të përcaktohen nga të ardhurat nga **taksat vendore**, ku rreth 62.6% e tyre mbledhet në bashkinë Tiranë. Të ardhurat nga tarifat vendore kontribuan negativisht në ecurinë e të ardhurave nga burime të veta vendore.



Kapaciteti i bashkive për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore paraqet diferenca të theksuara ndërmjet bashkive: rreth 62.6% e të ardhurave totale nga taksat vendore mbledhet në bashkinë Tiranë, ndjekur nga ajo Durrës me rreth 4.9%, Lezhë me rreth 3.5% nën efektin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.




Burimi: www.financatvendore.al

► **Të ardhura nga burime të veta vendore:**


- **Të ardhurat nga taksat;**
- Të ardhura nga tarifat vendore;
- Të ardhura të tjera nga burime vendore.

Të ardhurat nga taksat vendore regjistruan një nivel prej rreth 13.3. miliardë lekë, në rritje me rreth 35.5% në terma vjetorë. Përfshirë bashkinë Tiranë, të ardhurat nga taksat vendore shënuan një nivel prej rreth 5 miliard lekë, në rritje me rreth 9.4% në terma vjetorë.




Burimi: www.financatvendore.al

Performanca e të ardhurave nga **taksat vendore** është përcaktuar nga dy elementë: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe taksat mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesa, tokë bujqësore, truall) të cilat së bashku përfaqësojnë rreth 85.5% të të ardhurave nga taksat vendore.



Burimi: www.financatvendore.al


Të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme regjistruan një vlerë prej rreth 4.2 miliardë lekë, në rënie të lehtë me rreth 0.7% në terma vjetorë. Peshën dhe kontributin kryesor në të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme e japin të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën.



Burimi: www.financatvendore.al

Të ardhura nga aksa mbi pasuritë e paluajtshme:


■ Durrës ■ Elbasan ■ Fier ■ Korçë ■ Shkodër
■ Tiranë ■ Vlorë ■ Vorë ■ Të tjerë



Sipas bashkive, rreth 45.6% e të ardhurave nga taksa për pasuritë e paluajtshme mbledhet në bashkinë Tiranë, rezultat i përqendrimit të një numri të lartë ndërtesash në këtë territor. Bashkia Durrës renditet e dyta për nga pesha në të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme me rreth 7.6% ndaj totalit për periudhën e konsideruar dhe bashkia Fier e treta me rreth 4.6% ndaj totalit.


Të ardhurat nga **taksa mbi ndërtesat** regjistruan një nivel prej rreth 3.3 miliard lekë, në rritje me rreth **2.9%** në terma vjetorë, mbledhur për rreth 49.2% në bashkinë Tiranë.

Të ardhura nga taksa e ndërtesës:




Të ardhurat nga **taksa mbi token bujqësore** regjistruan një nivel prej rreth 354.2 milionë lekë, në rëne me rreth **22.7%** në terma vjetorë, mbledhur për rreth 12.4% në bashkinë Fier.

Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore:



Të ardhurat nga **taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja** shënuan një nivel prej rreth 7.2 miliardë lekë, në rritje me rreth 91.7% në terma vjetorë. Përfshirë të ardhurat për TNI nga bashkia Tiranë, 60 bashkitë e tjera në vend mblodhën rreth 1.9 miliard lekë nga kjo taksë, në rritje me rreth 53.6% në terma vjetorë.


Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në miliardë lekë:




Burimi: www.financatvendore.al

Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja (pasha ndaj totalit):

Bashkia Tiranë arkëtoi rreth 5.3 miliardë lekë (në rritje me rreth 110.8% në terma vjetorë) ose rreth 73.3% të të ardhurave totale nga kjo taksë. Në të kundërt, bashkitë Memaliaj dhe Kuçovë rezultojnë të mos ketë gjeneruar të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për periudhën në analizë. Në bashkinë Lezhë, nga kjo taksë rezulton të jenë zgjeruar nga një nivel prej rreth 62.7 milionë lekë në rreth 368.6 milionë lekë gjatë periudhës në analizë dhe në bashkinë Durrës nga rreth 176.9 milionë në rreth 249 milionë lekë.



Të ardhurat nga **taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja** mesatarisht përfaqësojnë rreth 54.5% të të ardhurave nga taksat vendore. Për rreth 20% të bashkive, të ardhurat nga kjo taksë qëndrojnë mbi mesataren kombëtare. Ndërkohë, në rreth 13% të bashkive të ardhurat nga kjo taksë përfaqësojnë më pak se 10% të të ardhurave nga taksat vendore duke reflektuar deri diku edhe presionet më të ulëta zhvillimit.




► **Të ardhura nga burime të veta vendore:**

- Të ardhurat nga taskat;
- **Të ardhura nga tarifatat vendore;**
- Të ardhura të tjera nga burime vendore.


Të ardhurat nga tarifat vendore regjistruan një nivel prej rreth 7.4 miliardë lekë, në rënie me rreth 0.9% në terma vjetorë. Kjo rënie u përcaktua nga tkurrja e të ardhurave nga tarifat vendore me rreth 7.7% në bashkinë Tiranë e cila mblodhi rreth 42.8% të të ardhurave totale nga tarifat vendore.

Të ardhurat nga tarifat vendore (në miliardë lekë):



Burimi: www.financatvendore.al


Tarifat e shërbimeve publike vendore
(pesha e kategorive ndaj totalit):



Të ardhurat nga **tarifat për shërbimet publike** vendore shënuan një vlerë prej rreth 3.5 miliardë lekë, në rënie me rreth 6.8% në terma vjetorë . Rënia e të ardhurave nga tarifat u përcaktua nga ngushtimi i të ardhurave nga tarifat për të gjitha kategoritë e shërbimeve publike të konsideruara.

Kryesisht, kahu i zhvillimeve për këtë kategori u diktua nga tkurja e të ardhurave nga tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave (tarifa e pastrimit) e cila zë dhe peshën më të madhe (rreth 88.4%)

Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave:




Të ardhurat nga **tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave** shënuan një vlerë prej rreth 1.1 miliardë lekë, në rritje me rreth 2.1% në terma vjetorë. Ndër kategoritë përbërëse, të hyrat nga zënia dhe përdorimi i hapësirave publike për bare dhe restorante dhe parkim, shënuan rritje me rreth 1.2 dhe 4.4% në terma vjetorë. Në të kundërt, përdorimi i hapësirave publike me qëllime reklamimi shënoi rënie me rreth 2.7% në terma vjetorë.

► Të ardhura nga taksat e ndara:

- 25% të të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
- 5% të të ardhurave nga renta minerare;
- 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.
- 97% e të ardhurave nga taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për individë, persona fizikë dhe juridikë*

** Në analizë ky zë është përfshirë në të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme dhe nuk do të trajtohet si taksë e ndarë.*


Të ardhurat taksat e ndara përfaqësojnë rreth 5.6% ndaj burimeve financiare totale të bashkive. Në tërësi, këto të ardhura kontribuan me rreth 1.1 miliardë lekë në buxhetin vendor, në rritje me rreth 15.5% në terma vjetorë.



Burimi: www.financatvendore.al

- ▶ **Të ardhura transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale**


Transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale përbën një burim financiar thelbësor në përmbushje të funksioneve të bashkive, duke synuar mbylljen e hendekut negative mes kapacitetit fiskal dhe nevojës për shpenzime. Gjatë periudhës në analizë, të hyrat nga ky burim rezultuan në rritje me rreth 4.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Burimi: www.financatvendore.al


Transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale përbën burimin financiar kryesor për bashkitë duke përfaqësuar mesatarisht 46.6% të burimeve financiare të disponueshme. Rëndësia e këtij burimi bëhet më e dukshme në nivel bashkie, ku në rreth 85% të bashkive (ose 52 prej tyre) pesha e këtij burimi qëndron mbi mesataren kombëtare.

Raport: të ardhura nga transferata e pakushtëzuar dhe sektoriale ndaj burimeve financiare të disponueshme



▶ **Transferta të kushtëzuara**
(për funksionet e deleguara)


Transfertat e kushtëzuara jepen për ushtrimin e funksioneve të deleguara dhe financimin e projekteve të veçanta. Gjatë periudhës në analizë, ato përfaqësuan rreth 34.1% ndaj burimeve financiare totale dhe shënuan rënie me rreth 5.2% në terma vjetorë.



Burimi: www.financatvendore.al


▶ **Huamarrja vendore & detyrimet e prapambetura**

Stoku i borxhit të qeverisjes vendore në fund të muajit qershor 2019 rezultoi në rreth 647.9 milionë lekë. Huaja vendore është përdorur në vitet 2010 dhe 2014 për financimin e projekteve infrastrukturore nga bashkitë Korçë, Pogradec, Vlorë, Elbasan, Lezhë dhe ish-komuna Petrelë (huaja e së cilës rezulton të jetë shlyer tërësisht).



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë & Instat

Stoku i detyrimeve të prapambetura shënoi një nivel prej rreth 6.6 miliardë lekë, në fund të muajit shtator 2019, në rënie të lehtë nga fundi i vitit 2018.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë & Instat


Detyrimet e prapambetura të bashkive u evidentuan në mënyrë sistematike duke filluar prej vitit 2015 në vijim të miratimit të VKM nr. 50/2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit" dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura". Bashkitë kanë raportuar mbi detyrimet e prapambetura, bazuar në planin e shlyerjes dërguar nga bashkitë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 1, datë 17.01.2019, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019".

► **Burime financiare totale**

- Burime financiare të disponueshme
- Transferta të kushtëzuara

Burimet financiare totale në dispozicion të bashkive në fund të nëntëmujorit të parë 2019 shënuan rritje me rreth 5.7% në terma vjetorë, nën ndikimin e rritjes së të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Burimet financiare totale sipas kategorive (në mld lekë):



Burimi: www.financatvendore.al

Qeverisja e hapur është qeverisje e përgjegjshme!

Përdorimi i burimeve financiare përgjatë 9M2019:


- Me fonde të veta, sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional;
- Me fonde të kushtëzuara, sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional;
- Shpenzime totale, sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional.

► **Shpenzimet e kryera me fonde të veta:**

- Sipas natyrës ekonomike të shpenzimeve;
- Sipas funksioneve të qeverisjes;


Shpenzimet me fonde të veta shënuan një nivel prej rreth 42.2 miliardë lekë në fund të 9M2019, në rritje me rreth 11.1% në terma vjetorë.

Shpenzime me fonde të veta (në miliardë lekë):




Burimi: www.financatvendore.al

Sipas **natyrës ekonomike**, zgjerimi i shpenzimeve të kryera me fonde të veta me rreth 11.1% në terma vjetorë u përcaktua gjerësisht nga rritja e shpenzimeve kapitale. Pozitivisht por në masë më të ulët kontribuoi edhe zgjerimi i shpenzimeve korrente.




Burimi: www.financatvendore.al

Bashkitë shpenzuan rreth 14 miliardë lekë për investime në fund të periudhës në analizë, në rritje me rreth 23.7% në terma vjetorë. Shpenzimet për personelin dhe ato operative dhe të tjera vijojnë të rriten ndonëse me ritme më të moderuara krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.




Burimi: www.financatvendore.al

Shpenzimet kapitale me fonde të veta paraqiten të luhatshme dhe paraqesin prirje rritëse nga viti në vit.



Burimi: www.financatvendore.al


Sipas funksioneve të qeverisjes, bashkitë alokuan rreth 25% të fondeve të veta në funksionin “Çështjet ekonomike”, rreth 21.5% në funksionet “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” dhe “shërbimet e përgjithshme publike”. Funksionet e “mbrojtjes sociale” dhe “mbrojtjes së mjedisit” përthithën rreth 3.2% të shpenzimeve me fonde të veta.



► **Shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara:**


- Sipas natyrës ekonomike të shpenzimeve
- Sipas funksioneve të qeverisjes

Shpenzimet me fonde të veta shënuan një nivel prej rreth 21.2 miliardë lekë në fund të 9M2019, në rënie me rreth 5.2% në terma vjetorë.




Burimi: www.financatvendore.al

Sipas natyrës ekonomike, bashkitë shpenzuan rreth 4.5 miliardë lekë për investime në fund të periudhës në analizë, në rënie me rreth 34.5% në terma vjetorë. Shpenzimet korrente (personel dhe operative dhe të tjera) shënuan rritje me rreth 7.6% në terma vjetorë.



Burimi: www.financatvendore.al

Sipas **funksioneve të qeverisjes**, shpenzimet në funksionin e “mbrojtjes sociale” përfaqësojnë rreth 73.5% të shpenzimeve totale (transferta për buxhetet familjare dhe PAK).




Burimi: www.financatvendore.al

► **Kosto e qeverisjes vendore në fund të 9M2019**


- Sipas natyrës ekonomike të shpenzimeve
- Sipas funksioneve të qeverisjes

Shpenzimet totale shënuan rritje me rreth 5.0% në terma vjetorë. 70.9% e fondeve shkoi për mbulimin e shpenzimeve korrente dhe 29.1% për shpenzime kapitale.



Burimi: www.financatvendore.al

Shpenzimet totale sipas klasifikimit ekonomik sugjerojnë se dy funksionet që përthithin fonde më shumë janë “mbrojtja sociale” dhe “strehimi dhe komoditetet e komunitetit”.



Burimi: www.financatvendore.al

PËRFUNDIME

- Burimet financiare totale janë rritur, por rritja **diktohet nga performanca e bashkisë Tiranë** dhe zhvillimet në dy taksa kryesore: **taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (TNI) dhe taksa e pronës;**
- Qartësisht, bashkia Tiranë përbën një entitet me karakteristika tërësisht të ndryshme nga 60 bashkitë e tjera në vend. Kjo ngre pyetje mbi **modelin e decentralizimit** të zbatuar në Shqipëri;
- **Varësia** nga të ardhurat nga **TNI** mbetet e lartë, për bashkitë ku kjo taksë ka peshë specifike të lartë – si një **e ardhur kapitale dhe jo e vazhdueshme;**
- Të ardhurat nga **taksa e pronës** janë larg pritshmërive, por në 2020 pritet një kontribut më i lartë në vijim të aplikimit të metodologjisë së re sipas vlerës së pronës;
- Të ardhurat nga **taksat e ndara** zënë peshë relativisht të ulët në buxhetin vendor por në të ardhmen mund të luajnë një rol më të rëndësishëm për të **zbutur deri diku diferencat në kapacitetin fiskal të bashkive;**
- Shtimi i mjeteve financiare u kanalizua gjerësisht në mbulimin e **shpenzimeve korrente**: shpenzime për paga, operative dhe të tjera;
- **Investimet totale** shënuan rritje të lehtë, diktuar nga rritja e investimeve me fonde të veta të bashkive;
- Funkcionet “mbrojtja sociale” dhe “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” përthithën mbi 45% të shpenzimeve totale;



www.financatvendore.al